



Në bazë të nenit 11 (njëmbëdhjetë) të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr. 02/2016,
Drejtoria e shkollës bën këtë:

FTESË PËR OFERTË

Pas vendimit të marrë nga Këshilli Drejtues i Shkollës dhe i Prindërve, ftojmë të gjitha agjencitë turistike të marrin pjesë në ftesën për ofertë të ekskursionit të maurantëve të SHMT "Skënder Luarasi" në Suharekë.

Ekskursioni do të zhvillohet në Republikën e Shqipërisë nga data 12 maj - 17maj 2019.
Kohëzgjatja e ekskursionit është 5 (pesë) netë (pansione të plota).

Në ekskursion do të marrin pjesë rreth 280 nxënës.

Në ofertë parashihet çmimi i akomodimit, ushqimit (mëngjesi + dreka + darka), transportit dhe shpenzimet e ndryshme që paraqiten me rastin e vizitave në muze dhe kala që parashihen në rrugëtimin e përcaktuar nga Këshilli i Shkollës.

Agjencionet turistike që konkurojnë duhet t'i plotësojnë këto parakushte:

1. Agjencioni duhet të ketë licencën " D " nga Ministria. Ofertës t'i bashkëngjiten fotokopjet e këtyre dokumenteve.
2. Të ketë bërë kontrollin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore-Ofertës t'i bashkëngjiten dëshmitë për këtë për të gjithë autobusët që do të përdorën në ekskursion.
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e ekskursionit
4. Duhet të ofroj dëshmi për akomodimin në Hotel në të cilin plotësohen kërkesat e Këshillit Drejtues të Shkollës dhe Prindërve (Siguria, Rrethojat, Ushqimi, Ballo për aktivitete të lira, projektor, hapësirë e dedikuar e promovimit të projekteve të nxënësve).
5. Për shoferet e angazhuar në ekskursion nga agjencioni duhet ti kenë certifikatën e mjekut, CPC-në dhe kopjet e patentshoferit .
6. Agjencioni duhet të siguroi përkujdesje mjekësore për pjesëmarrësit e ekskursionit gjatë tërë kohëzgjatjes së tij. Ofertës t'i bashkëngjiten leja e punës e mjekut dhe fotokopja e kontratës për përkujdesje gjatë tërë kohëzgjatjes së ekskursionit.
7. Afati i konkurimit 7 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit, ofertat dorëzohen në DKA në emër të shkollës.
8. OE i kërkohet të bëjë një konfirmim me shkrim që do të jetë në gjendje të mënjanoi shpejtë prishjet eventuale të ndonjë autobusi ose nëse është e nevojshme pa vonesë ta zëvendëson atë.
9. Dokumentet jashtë afatit të paraparë nuk pranohen.
10. Dokumentet jo complete nuk shqyrtohen.

Fituesi i ofertës do të zgjidhet operatori ekonomik, i cili i plotëson të gjitha kriteret e mësipërme dhe ka ofertën më të mirë, vlerësuar nga Komisioni, përbërja e të cilit është përcaktuar me UA 02/2016.

-Formulari i paraqitjes së ofertës dhe rrugëtimi i ekskursionit i hartuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës merren në SHMT "Skënder Luarasi" nga data 08.04.2019 në ora 08.00-15:00.

Pranimi i ofertave bëhet deri më: 19.04. 2019 deri në ora 13:00. Hapja e ofertës bëhet në SHMT "Skënder Luarasi" me datë: 19.04.2019 në ora 13:30.

Suharekë, 08.04.2019



Rr.: "Gjergj Kastrioti-Skenderbeu" 23000 Suharekë, Kosovë

Tel. 029/271 723, e-mail: shmskenderluarasi@gmail.com